
NJË MIQËSI UNIKE ME MODERATORIN E NJOHUR ADI KRASTA



ADRIAN (ADI) KRASTA – NJË JETË NË SHËRBIM TË EKRANIT DHE FJALËS PUBLIKE



Miqësia është një dhuratë e rrallë, por kur ajo lidhet me njerëz të cilët kanë ditur të ndikojnë në jetën publike e kulturore të një kombi, ajo merr një vlerë të veçantë. Një e tillë është miqësia ime me moderatorin e njohur shqiptar Adrian (Adi) Krasta, një figurë e shquar e ekranit, fjalës dhe reflektimit kritik.

Adi Krasta ka ditur gjithmonë të mbajë gjallë një lidhje të thellë me publikun. Ai nuk është vetëm një prezantues, por një mendimtar, një artist i fjalës që i jep kuptim çdo bisede. Në praninë e tij, qoftë në ekran, qoftë jashtë tij, gjithmonë ndjen se biseda merr një dimension më të gjerë – ku shkrirja e humorit me ironinë, e seriozitetit me pasionin, krijon një atmosferë unike.

Njohja me Adi Krastën fillon që në vitet e shërbimit tim në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) kur ai ishte gazetar i BBC. Me kalimin e kohës, kjo marrëdhënie është forcuar dhe pasuruar, duke u ndërtuar mbi afërsinë e mendimeve, mbi virtytet e ndara dhe mbi përkushtimin tonë të përbashkët për çështjet kombëtare shqiptare – në Shqipëri, Kosovë dhe në të gjitha territoret e tjera shqiptare në Ballkan.

Miqësia jonë ka pasur disa momente të paharrueshme, por një nga më të spikaturat është ajo e mbrëmjes së 7 marsit 2022, kur, bashkë me bashkëshorten time Donika, patëm nderin të jemi të pranishëm në monologun e tij brilant kushtuar mbrojtjes së Teatrit Kombëtar. Aty, Krasta nuk ishte thjesht një moderator: ai ishte një aktor i ndërgjegjes qytetare, një zë i fortë që thirri në emër të artit dhe kujtesës kombëtare. Fjalët e tij, të ngarkuara me emocione dhe kurajo, mbeten një kujtim i paharrueshëm.

Pas asaj nate, kur më 17 maj 2022 Teatri Kombëtar u shemb, kuptova edhe më shumë se sa e vlefshme ishte prania dhe zëri i Adi Krastës. Miqësia me të nuk është vetëm personale, por edhe një lidhje shpirtërore me idealet e tij për kulturën, lirinë dhe dinjitetin njerëzor.



Më pas, kam pasur disa herë nderin të jem i ftuar në emisionin e tij shumë të ndjekur, “A Krasta Show”. Në këto raste kemi zhvilluar biseda të hapura e të thella, duke trajtuar çështje me rëndësi të veçantë për publikun shqiptar, tema që lidhen me jetën shoqërore, politike dhe kulturore të vendit tonë. Përmes pyetjeve të tij të mprehta dhe mënyrës së veçantë të komunikimit, Adi Krasta i ka dhënë gjithnjë vlerë dhe peshë këtyre diskutimeve, duke i kthyer ato në një përvojë të paharrueshme për mua dhe, mbi të gjitha, në një shërbim të çmuar për shikuesin shqiptar.



Adi Krasta mbetet për mua një mik i çmuar dhe një njeri i rrallë, që nuk flet vetëm për realitetin, por edhe e sfidon atë. Dhe kjo e bën miqësinë me të një privilegj të veçantë, një miqësi unike që lidhet jo vetëm me njeriun, por edhe me misionin që ai përfaqëson në shoqërinë tonë.

BIOGRAFI E SHKURTËR E ADI KRASTËS



Adrian Krasta, i njohur nga të gjithë si Adi Krasta, lindi në Tiranë më 12 prill 1972. Që në moshë të re ai u tërhoq nga bota e kulturës dhe e artit, gjë që e çoi drejt mikrofonit të Radio Tiranës, ku nisi punën në fillim të viteve '90. Programi i tij i parë, "Jeta, Kultura, Arti", i hapi rrugën një karriere që do ta bënte një nga figurat më të njohura të ekranit shqiptar.

Hapat e parë në televizion i hodhi me emisionin "Letërsia dhe Pasqyrimet e saj" dhe më pas me "Mbrëmjet Kulturore". Publiku e njohu gjithnjë e më shumë kur, në vitin 1992, ai drejtoi emisionin "Spektër" dhe më pas, nën drejtimin e Vera Grabockës, emisionin e famshëm "12 Javë", që do të mbetej për shumëkënd simbol i rinisë dhe energjisë së asaj kohe.

Në vitet e trazuara të tranzicionit shqiptar, Krasta nuk u kufizua vetëm në ekran. Ai mori drejtimin e Radio Koha dhe më vonë, në vitin 2002, u bë drejtor i përgjithshëm i kanalit sportiv Telesport. Në ndërkohë, përjetoi një përvojë të çmuar ndërkombëtare në Londër, ku punoi për BBC World Service në seksionin shqiptar nga viti 1999 deri në vitin 2002.

Pas kthimit në Shqipëri, Krasta solli formate të reja televizive. Spektakli muzikor “Ethet e së Premtes Mbrëma”, i cili u krijua bashkë me Pali Kuken, u kthye në një fenomen kulturor. Ai prezantoi gjithashtu pesë edicione të Festivalit të Këngës në RTSH, duke hyrë në traditën e këtij eventi historik.

Karriera e tij u pasurua me bashkëpunime të gjata në Top Channel, ku ishte pjesë e programit të së dielës “E Diell”, si edhe në kanale të tjera si Agon Channel, News 24 dhe Syri TV. Emisioni i tij personal, “A Show”, i dha mundësinë të krijonte një hapësirë unike për dialog, monologë ironikë dhe analiza politike e shoqërore që shpesh provokonin debat.

Krasta nuk ishte vetëm moderator, por edhe figurë kritike, që përmes fjalës solli reflektim tek publiku. Monologët e tij, të mbushur me ironi, mendim dhe humor, u bënë një shenjë dalluese e stilit të tij. Ai u shfaq gjithashtu si juror në X Factor Albania, duke dëshmuar edhe lidhjen e tij me muzikën dhe artin.

Në një hap të rëndësishëm të karrierës së tij, më 14 janar 2023, ai u zgjodh Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Radio Televizionit të Kosovës (RTK), me votim unanim

nga Bordi i këtij institucioni. Ky rol i dha atij një tjetër dimension, atë të administratorit dhe reformatorit në një nga mediat publike më të rëndësishme të rajonit. Pas gati dy vitesh shërbimi, më 28 tetor 2024, ai dha dorëheqje, duke u kthyer sërish tek pasioni i tij i parë – ekrani dhe dialogu me publikun.

Sot, Adi Krasta vazhdon të mbetet një nga moderatorët më të spikatur dhe më me ndikim të Shqipërisë. Ai është i njohur jo vetëm për talentin në drejtimin e emisioneve, por edhe për guximin për të ngritur zërin, për të provokuar reflektim dhe për të ruajtur një integritet profesional që e bën të veçantë në peizazhin mediatik shqiptar.

MBRËMJA E 7 MARSIT 2022 – NJË MONOLOG PËR TEATRIN KOMBËTAR



Më 7 mars 2022, në një mbrëmje të paharrueshme, skena e Teatrit Kombëtar në Tiranë u mbush me zëra, emocione dhe frymë rezistence. Midis shumë artistëve dhe intelektualëve që i ishin bashkuar kauzës për mbrojtjen e këtij tempulli të kulturës shqiptare, doli përpara publikut moderatori i shquar Adrian Krasta, i cili mbajti një monolog që la gjurmë të thella në kujtesën e të gjithëve.

Në atë sallë ishin të pranishëm aktorët më të mirë shqiptarë, figura të skenës që për dekada kishin ngjallur duartrokitje, lot e reflektim. Ata nuk ishin aty vetëm për artin, por për të mbrojtur një simbol kombëtar, një shtëpi ku ishte shkruar historia e dramaturgjisë shqiptare. Çdo fjalë që dilte nga goja e Krastës, e artikuluar me pasion, me sarkazëm dhe me dhimbje të sinqertë, u bë një thirrje e fortë për të mos lejuar shkatërrimin e Teatrit.

Atmosfera ishte solemne, e ngarkuar me emocion. Bashkë me zonjën time, Donikën, patëm nderin të ishim të pranishëm e të dëshmonim këtë akt të jashtëzakonshëm të artit që ngrihet kundër harresës dhe dhunës mbi kulturën. Monologu i Krastës nuk ishte

thjesht një fjalim – ishte një akt rezistence, një shfaqje artistike në vetvete, që mbrojti me dinjitet kujtesën dhe shpirtin e një institucioni të papërsëritshëm.

Por, vetëm pak javë më vonë, ndodhi ajo që shumë e kishin frikësuar. Më 17 maj 2022, Bashkia e Tiranës e shembi Teatrin Kombëtar, duke e shndërruar atë natë të 7 marsit në një testament artistik. Fjala e Krastës dhe prania e aktorëve u kthyen në dëshmi të fundit publike të një kauze që nuk u dëgjua, por që mbetet e gdhendur në kujtesën e qytetarëve dhe në ndërgjegjen e kombit.

Mbrëmja e 7 marsit, me monologun e Adrian Krastës dhe me solidaritetin e aktorëve e intelektualëve, mbetet sot një gur i rëndë kujtese: një akt i lartë kulturor dhe qytetar, i cili na kujton se artin mund ta shembësh fizikisht, por shpirtin e tij nuk mund ta zhdukësh kurrë.

MONOLOGU I PLOTË I GAZETARIT ADI KRASTA NGA SALLA KRYESORE E TEATRIT KOMBËTAR

7 Mars 2022



Moderatori Adi Krasta është ngjitur sot në skenën e Teatrit Kombëtar në Tiranë për të mbajtur një monolog lidhur me kauzën e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit. Krasta është kundër prishjes së Teatrit dhe si një kritikues i njohur i qeverisë aktuale ka hedhur akuza mbi të se do të grabisë pronën mbi ku ndodhet Teatrit Kombëtar por nuk ka argument dhe as kohë.

Monologu i plotë i gazetarit Adi Krasta nga salla kryesore e Teatrit Kombëtar sonte datë 7 mars 2020: Që nga koha kur u mendua gabimisht se shoqëria civile korri një fitore të madhe kundër sjelljes së plehrave

kimike në fillim të kësaj qeverisjeje, nuk pati ndonjë betejë që të tregojë muskujt dhe zemrën e qytetarit të zakonshëm, që sillet tej pasionit politik. Qeverisja bëri atëherë një tërheqje të padëmshme për të dhe njerëzit lanë të lumtur sheshin drejt padijes së tyre. Sot, plehrat e rrezikshme, inceneratorët, drogat e forta, trafikantët, bashkiakë e deputetë me rekorde krimi, vrasës dhe dhunues të shëmtuar të grave, janë ulur këmbëkryq në trupin e një territori të vogël, që e quajmë me hipokrizi Atdhe i dashur e asnjë nerv lirie, reagimi apo dashurie nuk zgjohet më. Është vdekja e paguar e shoqërisë civile, për të cilën na u kërkua qysh në krye t'i rrëfenim atij varrin ku të vendoste lulen e triumfit.

Por deri para dy vjetësh... askush nuk mendoi se do të ishte një ndërtesë e lodhur por e bukur e një kompleksi, ku do të lindte ndoshta kauza më domethënëse dhe komplekse e 30 viteve të fundit: ajo për ruajtjen nga prishja dhe plaçkitja e Teatrit Kombëtar të Tiranës dhe e gjithë Shqipërisë. Është ai çast kur është kauza që gjen njeriun dhe e kthen në një kudhër zemërate dhe qartësimi. Në një protestues.

Dua t’ju flas se si e shoh unë këtë trini të shenjtë sonte: ndërtesën, njeriun dhe kauzën.

Ndërtesa është e hatashme. Ka arkitekturë tipike të viteve ‘30. Bën pjesë në njollën e vetme jo otomane të Tiranës: atë europiano-perëndimore. Nuk ka një njeri të mençur në Tiranë që nuk e kupton se rinovimi i kompleksit “Skënderbeg” me dy salla teatri, një pishinë, kopshte dhe një ndërtesë shik në fund jo vetëm do t’i bënte nder kujtesës kolektive dhe emocionit njerëzor, por do të shërbente si një antidot kundër çmendurisë frymëmbajtëse të qytetit të sotëm. Kjo kauzë nuk do të ekzistonte nëse nuk do të bëhej menjëherë e QARTË dhe e konfirmueshme se teatri si ndërtesë nuk ka as më të voglën rëndësi për prishësit. Padyshim as ndërtimi i një teatri të ri, që është vetëm alibi. Është plaçkitja e tokës së tij që vlen. Kullat ishin dhe janë kali i Trojës së qytetit të sotëm. Sfida që ai bën të krijon një ndjesi disfatizmi, rënieje, vdekjeje. Ndaj ajo që Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka bërë gjatë këtyre dy viteve është sa e madhe, aq edhe e natyrshme. Te qytetarët që e shohin këtë teatër e këtë skenë çdo ditë me dashuri e merak duhet kërkuar çelësi për të kuptuar

shqiptarin e sotëm. Te ky teatër janë ngjizur në një: tempulli, njeriu dhe vetë kauza.

Të gjithëve na ka bërë përshtypje fraza "kam parë qytet pa bulevard, por nuk kam parë bulevard pa qytet". Në natën neroniane të shkatërrimeve, një natë e Bartolomeut për stadiumin "Qemal Stafa", që e nxorën vërtik nga mbrojtja e monumenteve për të ndërtuar një qendër brutale biznesi me një bahçe të vogël për kalçeto, ndërtesat e njollës më moderne të Tiranës po bien një nga një. Ato, të pagoja, jam i bindur se me shpirtin e njerëzve që kanë jetuar, qeshur, qarë, ëndërruar e janë shuar brenda tyre e kuptojnë se një skuadër pushkatimi po i shfaros.

Teatri Kombëtar duket sikur me një fuqi shekspiriane të veprave që janë interpretuar këtu, merr përsipër të frymëzojë kauzën. Kjo kauzë thërret njerëzit. Ata përgjigjen. Skuadra e pushkatimit e di se të qëllojë teatrin mund të përshpejtojë në mënyrë të paparashikueshme vdekjen e vetë qëlluesve. Ndaj kjo betejë nervash, retorikash, durimi, lobimi, argumentesh juridike e morale zbret në një fushë, e cila është më e jashtëzakonshmja: koha. Teatri, si një

kështjellë, duhet të fitojë kohë. Rrethuesit pikërisht kohë nuk do të kenë të presin gjatë. Shpejt a vonë, do të humbin pushtet dhe nëse nuk nxitojnë me dredhi e hile, siç bëjnë gjithmonë rrethuesit, duke blerë tradhtarë dhe joshur qëndrestarë, duke sharë e shantazhuar, nuk do të mundin ta prishin kompleksin “Skënderbeg” për të ndërtuar kullat e premtuara, që bashkë me paratë shpëlajnë një herë e mirë sqimën qytetare, kujtesën tonë e atë historike.

Le të përpiqemi të bëjmë një identikit të rrethuesve. Ata duket sikur nuk dinë e nuk munden ta duan teatrin si art. As aktorin si artist. As skenën si vend i shenjtë. Padyshim, publikun e shohin si një votues militant, idiot dhe pa mendim. Nuk shihen shtresime kulturore në retorikën e tyre. Një lloj boshi që i dallohet në sy njeriut në skuadrën e pushkatimit. Sidomos më të riut. Në entuziazmin fake të servilizmit i dallohet pamundësia për të ndjerë.

Brenda kështjellës jeni ju. Heronjtë e përditshëm. Ju shoh dhe e ndiej të domosdoshme që për t’ju lartësuar të përpiqem të lexoj kundërfigurat tuaja.

Ata janë gjithashtu qytetarë të këtij qyteti. Por janë apatikë (të mundur), të frikësuar. Sidomos të frikësuar. Për ta, fatkeqësisht, rënia e teatrit nuk është rënia e lirisë, edhe pse ndoshta brenda zërit që nuk dëgjohet pranojnë se arti është shprehje e lirisë.

Ajo që po ndodh këtu është kjo: qeveria e bashkia duan ta plaçkitin tokën e kompleksit “Skënderbeg” që të ndërtojnë kulla. Kaq. Është vetëm kaq. Prandaj është një rrethim këmbëngulës. Ata nuk kanë argument, por mbi të gjitha nuk kanë kohë. Dhe mungesa e kohës i detyron të bëjnë artifica politike dhe gabime e gafa konceptuale. Një prej flluskave më të zhbëshme të hedhura për konsum publik është se disa artistë e qytetarë të Tiranës nuk e duan zhvillimin. Se pasi Tirana të ndryshojë plotësisht, duke u çnatyruar përtej njohjes, ata që me kokëfortësi, zemër të ftohtë kalkulative, hile banale procedurash dhe gënjeshtra të blera në mediat e tyre sot po sulmohen në publik si lakmitarë e hajdutë, nesër do të shihen si largpamës e revolucionarë. Kjo është po aq e pasaktë sa ç’është bosh çdokush që e artikulon si mbrojtje. Ajo që shohim nuk ka lidhje me stilin arkitekturor, ndërsa te stadiumi

nuk ka lidhje vetëm me plaçkitjen e tokës. Stadiumi i sotëm me emrin e një kompanie pothuaj turke do mbetet një ndërtesë brutale. Banale. Nuk i shërben sportit, por biznesit. Dhe është e pabukur.

Prishja e teatrit, ndërtimi i kullave aty, prishja e hotelit “Vjosa”, ndërtimi i ndërtesës së florinjtë te hotel “Tirana” dhe çdo gërryerje e paturpshme e asaj që Tiranën e ka bërë Tiranë nuk është zhvillim. Është hajdutëri, lakmi, narcizizëm, abuzim me pushtetin dhe arrogancë. Në këtë algoritëm mental të qeverisësve të momentit ka gjithsesi një gabim, të cilin duket se nuk duan ta shohin. E ardhmja mund t’u rezervojë atyre një befasi. Pavarësisht qetësisë së momentit, gjithçka që kanë bërë nuk do të kalojë e pandëshkuar.

Ndaj qyteti duhet të rezistojë. Fillimisht nga mbrojtësit e tij më entuziastë, pra heronjtë e tij. Më pas prej të gjithëve ne.



Unë kam shumë miq e të afërm, të cilët e di që do të kishin dashur të ishin këtu sot. Jam i tronditur nga mesazhet e shumta që kam marrë prej të njohurish e të panjohurish këto ditë se frika, një frikë e madhe i pengon të vijnë. E paprecedentë në këtë përmasë dhe e krahasueshme vetëm me regjime paçavure pushtetesh. Kjo që kanë prodhuar është fatkeqësi e madhe për ne të gjithë e për këtë vend, por është edhe ndëshkimi më i madh për ta. Kjo është arritja e vetme e një mendësie burracakësh pushteti, që nuk bënë dot as Shqipërinë e as historinë e tyre.

Në qeverisjen e kaluar, ne thamë fjalën tonë me të njëjtin nerv kundër prishjes së piramidës si pronë e

qytetit dhe dëshmi e historisë dhe ajo është aty ende. Ja ku jemi sërish për të mbrojtur Teatrin Kombëtar në një qeverisje tjetër. Ku janë ata qindra e mijëra vajza e djem Tirane që heshtin? Duhet të ndihen keq, jam i sigurt. Në boshin dhe shungullimën e mendimeve, në vetminë e tyre, larg interesave të kohës, ata e dinë se kompleksi "Skënderbeg" mund të rinovohej mrekullisht për t'u sjellë në kohën e lavdishme të ndërtimit.

Dhe po, ka gazetari të angazhuar pa qenë bythëlëpirëse. Dhe po, mund ta kesh personale kur pushteti e ka personale. Rrethuesit e kështjellës i përcaktojnë sinorët. Ata të thajnë puset, të helmojnë ajrin, të mbysin shpirtin e lirë, të varfërojnë jetën, të zvjerdhin atdheun, të bëjnë të largohesh. Kjo është personale. Ndërsa të gjithë ata që çirren e bërtasin për të bërë vokalin e liderit, për ata do të duhet të ndihet vetëm keqardhje. Është i rëndë pushtimi i shpirtit. Duhet të jetë si veshja e detyruar e një këmishe force.

Ndërkohë Shqipëria kurrë nuk ka qenë më e sëmurë se sot. E drobitur nga kanabizimi i territorit të saj dhe dalldia për të mbjellë e trafikuar.
Ajo sot është në vendin e parë në botë për numrin e

azilkërkuesve. Ajo humb çdo vit e çdo ditë pikë në rekorde e statistika që matin demokracinë. Ajo është ende jashtë e larg Europës. Ajo ka rritur borxhin. Ajo është ende më e varfra në Europë. Ajo ende nuk po kupton nëse bandat udhëheqin politikën apo politika udhëheq me banda. Administrata e saj është militante. Parlamenti i saj është qesharak. Qeverisja është e paaftë dhe e korruptuar .

Sot nuk jemi më në momentin e perceptimit. Gjithçka është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Unë dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj rrezikun e veçantë, të paparashikueshëm që sjell segmenti i fundit para lënies së pushtetit. Është ai kapërcyell kur mund të bëhen krime të mëdha kundër atdheut me lehtësinë e papërballueshme të fundit dhe vetëdijes se pushteti nuk të vjen më kurrë në dorë. Është ai moment që i ka trimëruar edhe më frikacakët. Një lloj lejeje për të mëkatuar ndërkohë që përgatitet apres moi le deluge. Ky segment i fundit është fillimi i riharrimit, ndaj bëhet i rrezikshëm. Sepse nuk ka pika referenciale. Lidhjet me realitetin janë shkëputur dhe bisedat rreth teje, qeverisësit, janë bërë pa përmbajtje. Njeriu me pushtetin e segmentit të fundit ka një boshllëk në sytë

e tij. Në zemrën e tij. Gjen një interes të sëmurë e mbytës tek ata që e rrethojnë. Ndaj Teatri Kombëtar tani është një kauzë që ka lidhje të fortë me kohën. Duhet të rezistojë në kohë. Në këtë segment të fundit, si në ditët e fundit të Romës, kur Neroni gjeti gjithë forcën e zhveshur nga arsyeja për ta djegur. Teatri Kombëtar i plotëson të gjitha kushtet për t'u urryer nga qeverisja e sotme. Nga prishja e tij dhe ndërtimi i kullave mund të grabsen 200 milionë euro. Edhe pse rrethuesit nuk e fshehin një gëzim për rrënimin fizik të tij.

Zonja dhe zotërinj, Teatri Kombëtar nuk do të prishet. Nuk duhet të prishet. Qytetarët e Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë e të Kosovës, shqiptarët në Maqedoni e Mal të Zi dhe në të gjithë diasporën duhet të bëhen të ndjeshëm. Sot Teatri është Atdheu.

Adi Krasta

